



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

**PROJEKTLIGJI PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME
TË KOMUNËS¹**

**DRAFT LAW ON ALLOCATION FOR USE AND EXCHANGE OF MUNICIPAL IMMOVABLE
PROPERTY²**

**NACRT ZAKON O DAVANJU NA KORIŠĆENJE I O RAZMENI OPŠTINSKE NEPOKRETNE
IMOVINE³**

¹ Projektligji për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, është miratuar në mbledhjen e 55- të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 04/55 të datës 06.07.2018.

² Draft law on allocation for use and exchange of municipal immovable property, was approved in the 55 - meeting of the Government of Republic of Kosova with the decision No: 04/55 dt: 06.07.2018.

³Nacrt Zakona o davanju na korišćenje i o razmeni opštinske nepokretne imovine, usvojenje na 55- sednici Vlade Republike Kosova, odlukom br: 04/55 dt: 06.07.2018.

<p>Kuvendi i Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p>LIGJ PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS</p> <p>KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME</p> <p>Neni 1 Qëllimi</p> <p>1. Ky ligj ka për qëllim të siguroj shfrytëzimin efektiv të pronës së paluajtshme të komunës për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, rritjen e vlerës së pronës së paluajtshme të komunës dhe përmbushjes së interesit të përgjithshëm. Gjithashtu ky ligj krijon mundësi për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunave dhe përfitimin e të drejtës së pronësisë për komunat mbi pronat</p>	<p>Assembly of the Republic of Kosovo,</p> <p>Based on Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>Approves:</p> <p>LAW ON ALLOCATION FOR USE AND EXCHANGE OF MUNICIPAL IMMOVABLE PROPERTY</p> <p>CHAPTER I GENERAL PROVISION</p> <p>Article 1 Purpose</p> <p>1. This Law aims at ensuring the effective use of immovable property of the municipality for sustainable economic development, increase in value of the immovable property of the municipality and fulfilment of the general interest. This Law also provides opportunity for exchanging the immovable property of the municipalities and acquisition of the ownership right by municipalities over the properties administered by state institutions, in</p>	<p>Skupština Republike Kosova,</p> <p>Na osnovu člana 65. stava 1. Ustava Republike Kosova,</p> <p>Usvaja:</p> <p>ZAKON O DAVANJU NA KORIŠĆENJE I O RAZMENI OPŠTINSKE NEPOKRETNE IMOVINE</p> <p>POGLAVLJE OPŠTE ODREDBE</p> <p>Član 1 Svrha</p> <p>1. Svrha ovog zakona je obezbeđivanje efikasnog korišćenja opštinske nepokretne imovine za održiv ekonomski razvoj, povećanje vrednosti opštinske nepokretne imovine i ispunjavanje opšteg interesa. Takođe, ovaj zakon omogućuje razmenu opštinske nepokretne imovine i sticanje prava vlasništva od strane opština nad imovinom kojom upravljaju državne institucije, radi ispunjavanja opšteg javnog</p>
--	--	--

<p>të cilat administrohen nga institucionet e shtetit, me qëllim të përmbushjes së interesit të përgjithshëm publik.</p> <p>2. Me këtë ligj rregullohen dhe përcaktohen procedurat dhe format për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe procedurat e bartjes së pronave të paluajtshme të cilat administrohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit në pronësi të komunës.</p>	<p>view of fulfilling the general public interest.</p> <p>2. This Law regulates the forms and procedures for use and exchange of immovable property of the municipality and procedures of transferring the ownership of the immovable property managed by the Privatization Agency of Kosovo to the municipality.</p>	<p>interesa.</p> <p>2. Ovim zakonom uređuju se i utvrđuju procedure i oblici davanja na korišćenje i razmenu opštinske nepokretne imovine, kao i procedure za prenos nepokretne imovine kojom rukovodi Kosovska agencija za privatizaciju, u vlasništvo opštine.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 2 Fushëveprimi</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Scope</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Delokrug</p>
<p>Dispozitat e këtij ligji zbatohen nga organet e komunave, institucionet shtetërore, personat fizik dhe juridik.</p>	<p>The provisions of this Law shall be implemented by municipal bodies, state institutions, and natural and legal persons.</p>	<p>Odredbe ovog zakona sprovode opštinski organi, državne institucije, fizička i pravna lica.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizimet</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Definitions</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Definicije</p>
<p>1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1. Pronë e paluajtshme e komunës - nënkupton pronën e paluajtshme e regjistruar në emër të komunës në Regjistrin e të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme;</p>	<p>1. Terms used in this Law shall have the following meaning:</p> <p>1.1. Immovable property of the Municipality - shall mean the immovable property registered on behalf of the Municipality in the Immovable Property Rights Register;</p>	<p>1. Izrazi upotrebljeni u ovom zakonu imaju sledeće značenje:</p> <p>1.1. Nepokretna opštinska imovina - podrazumeva nepokretnu imovinu registrovanu u ime opštine u Registar prava nad nepokretnom imovinom;</p>

<p>1.2. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës - nënkupton pronën e paluajtshme të komunës duke përfshirë tokën dhe objektet që janë në pronësi të komunës të cilat jepen në shfrytëzim sipas procedurave të përcaktuara me këtë ligj;</p> <p>1.3. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës - nënkupton periudhën kohore më shumë se një (1) vit deri në pesëmbëdhjetë (15) vite;</p> <p>1.4. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës - nënkupton periudhën kohore më shumë se pesëmbëdhjetë (15) deri nëntëdhjetë e nëntë (99) vite;</p> <p>1.5. Këmbimi - nënkupton të drejtën e komunës për të bërë ndërrimin e pronës së paluajtshme të komunës me personat fizik, juridik dhe institucionet qendrore për qëllime të interesit publik;</p> <p>1.6. AKP - nënkupton Agjencinë Kosovare të Privatizimit sipas Ligjit përkatës të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;</p>	<p>1.2. Allocation for use of immovable property of the municipality - shall mean the allocation of immovable property for use, including municipally owned land and buildings, according to procedures provided by this Law;</p> <p>1.3. Period for allocation for short-term use of immovable property of the municipality – shall mean the time period of more than one (1) year to fifteen (15) years;</p> <p>1.4. Period for allocation for long-term use of immovable property of the municipality - shall mean the time period of more than fifteen (15) to ninety-nine (99) years;</p> <p>1.5. Exchange - shall mean the right of the Municipality to exchange the immovable property of the municipality with natural and legal persons and central institutions for the purposes of public interest;</p> <p>1.6. PAK - shall mean the Privatisation Agency of Kosovo, pursuant to the relevant Law on Privatisation Agency of Kosovo;</p>	<p>1.2. Davanje opštinske imovine na korišćenje - podrazumeva nepokretnu imovinu opštine uključujući zemljište i objekte koji su u vlasništvu opštine koja se daje na korišćenje prema procedurama utvrđenim ovim zakonom;</p> <p>1.3. Vremenski rok za kratkoročno davanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine—podrazumeva period duži od jedne (1) godine do petnaest (15) godina;</p> <p>1.4. Vremenski rok za dugoročno davanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine—podrazumeva period duži od petnaest (15) do devedeset devet (99) godina;</p> <p>1.5. Razmena – podrazumeva pravo opštine da razmeni nepokretnu opštinsku imovinu sa fizičkim i pravnim licima, centralnim institucijama i KAP-om za svrhe javnog interesa;</p> <p>1.6. KAP - podrazumeva Kosovsku agenciju za privatizaciju prema relevantnom zakonu o Kosovskoj agenciji za privatizaciju;</p>
--	--	--

<p>1.7. Komunë - nënkupton përkufizimin e përcaktuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale;</p> <p>1.8. Pronar - nënkupton personin fizik apo juridik i cili është titullar i pronës në bazë të Regjistrit të të Drejtave për Pronën e Paluajtshme;</p> <p>1.9. Qeveria - nënkupton Qeverinë e cila ushtron pushtetin e vetë ekzekutiv në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;</p> <p>1.10. Ministria - nënkupton Ministrinë përgjegjëse për Vetëqeverisjen Lokale;</p> <p>1.11. Ankand publik - nënkupton procesin e konkurrencës së hapur ku fituesi zgjidhet në bazë të çmimit më të lartë të ofruar dhe në raste specifike kriterëve tjera të përcaktuara me ankand;</p> <p>1.12. Shprehja e interesit - nënkupton procesin e konkurrencës së hapur ku fituesi zgjidhet në bazë të kriterëve të specifikuar në thirrjen për ofertë;</p>	<p>1.7. Municipality - shall mean the definition stipulated in the Law on Local Self-Government;</p> <p>1.8. Owner - shall mean the natural or legal person, who is the title holder of property based on the Immovable Property Rights Register;</p> <p>1.9. Government- shall mean the Government which exercises its executive power in compliance with the Constitution and legislation in force;</p> <p>1.10. Ministry - shall mean the responsible Ministry for Local Self-Government;</p> <p>1.11. Public Auction - shall mean the process of open competition in which the winner is selected based on the highest price offered and in specific cases, other criteria established by the auction;</p> <p>1.12. Expression of interest - shall mean the public competition process, where the winner is selected based on the criteria specified in the call for bids;</p>	<p>1.7. Opština - podrazumeva definiciju utvrđenu Zakonom o lokalnoj samoupravi;</p> <p>1.8. Vlasnik – podrazumeva fizičko ili pravno lice koje je titular imovine na osnovu Registra prava na nepokretnu imovinu;</p> <p>1.9. Vlada - podrazumeva Vladu koja vrši izvršnu vlast u skladu sa Ustavom i važećim zakonima;</p> <p>1.10. Ministarstvo - podrazumeva ministarstvo odgovorno za lokalnu samoupravu;</p> <p>1.11. Javna aukcija - podrazumeva proces otvorene konkurencije u kojem je pobednik izabran na osnovu najviše ponudene cene i u posebnim slučajevima na osnovu drugih kriterijuma utvrđenih aukcijom;</p> <p>1.12. Izražavanje interesa - podrazumeva proceduru otvorenog konkurisanja u kome je pobednik izabran na osnovu kriterijuma navedenih u pozivu za ponudu;</p>
---	--	--

<p>1.13. Interesi i përgjithshëm publik- nënkupton dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, këmbimin apo kërkesën për kthimin e saj në pronësi të komunës, e që ka për qëllim shfrytëzimin apo destinimin e saj në të mirë dhe interes të përgjithshëm të qytetarëve, nga personat fizik dhe juridik, në pajtim me dokumentet për planifikimin hapësinor dhe legjislacionin në fuqi;</p> <p>1.14. Organi për vlerësimin financiar të pronës e cila këmbëhet - nënkupton organin i cili bën vlerësimin financiar të pronës në kuadër të ministrisë përgjegjëse për financa.</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 Parimet e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës</p> <p>1. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës bëhet duke u bazuar në këto parime:</p> <p>1.1 Parimi i ligjshmërisë - nënkupton se dhënia në shfrytëzim dhe këmbimi i pronës së paluajtshme të komunës duhet të bazohen në Kushtetutë, ligj dhe aktet e tjera nënligjore;</p>	<p>1.13. General Public Interest – shall mean the allocation for use of immovable property of the municipality, exchange or request for returning it to the municipality, with the aim of its better use or destination and in the general interest of citizens, from natural and legal persons, in compliance with the spatial planning documents and legislation in force;</p> <p>1.14. Body on financial assessment of the property for exchange - shall mean the body that performs the financial assessment, which operates within the ministry responsible for finances.</p> <p style="text-align: center;">Article 4 Principles of allocation for use of immovable property of the municipality</p> <p>1. Immovable property of the municipality shall be allocated based on the following principles:</p> <p>1.1 Principle of legality – shall mean that the allocation for use and exchange of immovable property of the municipality should be based on the Constitution, Law and other bylaws;</p>	<p>1.13. Opšti javni interes - podrazumeva davanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine, razmenu ili zahtev za njen povratak u vlasništvo opštine radi njenog boljeg korišćenja i namene u korist i opšti interes građana od strane fizičkih i pravnih lica, u skladu sa dokumentima o prostornom planiranju i važećem zakonodavstvu;</p> <p>1.14. Organ za finansijsku procenu imovine koja se razmenjuje - podrazumeva organ koji vrši finansijsku procenu imovine u okviru ministarstva odgovorne za finansije.</p> <p style="text-align: center;">Član 4 Principi davanja na korišćenje opštinske nepokretne imovine</p> <p>1. Davanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine vrši se na osnovu sledećih principa:</p> <p>1.1 Princip zakonitosti - podrazumeva da davanje na korišćenje i razmena opštinske nepokretnosti mora da se zasniva na Ustavu, zakonu i drugim podzakonskim aktima;</p>
--	--	--

<p>1.2 Parimi i efikasitetit - nënkupton se organet e komunës zhvillojnë procedurën për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, sa më shpejtë dhe sa më pak shpenzime për komunën dhe për palët, duke siguruar edhe qëllimin e dhënies së pronës për përmbushjen e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik lokal;</p> <p>1.3 Parimi i trajtimit të barabartë të palëve - nënkupton se të gjitha palët në procesin e dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, trajtohen në mënyrë të barabartë, duke shmangur çdo diskriminim ndaj palëve dhe duke vepruar në mënyrë objektive dhe të paanshme ndaj të gjithëve;</p> <p>1.4 Parimi i transparencës - nënkupton se organet e komunës duhet të veprojnë me transparencë, të respektojnë dhe të garantojnë të drejtat e palëve për t'u informuar lidhur me procedurat, kushtet dhe ecurinë e dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës;</p>	<p>1.2 Principle of effectiveness – shall mean that municipal bodies carry out the procedure for allocation for use and exchange of immovable property of the municipality as soon as possible and with lowest possible cost for the municipality and parties, ensuring the purpose of allocation of the property for fulfilling the public interest and local economic development;</p> <p>1.3 Principle of equal treatment of parties – shall mean that all parties in the process for allocation and exchange of immovable property of the municipality are equally treated, avoiding any discrimination against parties and acting objectively and impartially towards all;</p> <p>1.4 Principle of transparency – shall mean that municipal bodies should act with transparency, respect and guarantee the rights of parties to be informed for procedures, conditions and progress of allocation for use and exchange of immovable property of the municipality;</p>	<p>1.2 Princip efikasnosti - podrazumeva da opštinski organi razvijaju postupak za davanje na korišćenje i razmenu nepokretne opštinske imovine opštine što je brže moguće i uz što manje troškova za opštinu i za strane, obezbeđujući i svrhu davanja imovine za ispunjavanje javnog interesa i lokalnog ekonomskog razvoja;</p> <p>1.3 Princip jednakog tretmana strana - podrazumeva da se sve strane u procesu davanja na korišćenje i razmene opštinske nepokretne imovine jednako tretiraju, izbegavajući bilo kakvu diskriminaciju prema stranama i delujući objektivno i nepristrasno prema svima;</p> <p>1.4 Princip transparentnosti - podrazumeva da opštinski organi treba da deluju transparentno, poštuju i garantuju prava strana da budu obavesteni o procedurama, uslovima i toku davanja na korišćenje i razmenu opštinske nepokretne imovine;</p>
--	---	--

<p>1.5 Parimi i ruajtjes dhe rritjes së vlerës së pronës publike të komunës - nënkupton se shfrytëzuesi i pronës komunale është i detyruar që pronën ta shfrytëzoj në atë mënyrën që ta ruaj vlerën e saj dhe të përdorë të gjitha masat përkatëse për rritjen e kësaj vlere;</p> <p>1.6 Parimi i ruajtjes së karakteristikave dhe vlerave unike të pronës -nënkupton se, shfrytëzuesi i pronës komunale, duhet ta shfrytëzoj pronën vetëm sipas destinimit të pronës duke ruajtur vlerat e saj kulturore, historike, arkeologjike, arkitekturën historike dhe çdo vlerë tjetër unike të saj, ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>1.5 Principle of protecting and increasing the value of the municipal public property – shall mean that the user of the municipal property is obliged to use the property in such a manner as to protect its value and take all measures necessary for increasing that value;</p> <p>1.6 Principle of protecting the characteristics and unique values of the property –shall mean that the user of the municipal property should use the property only according to the destination of the property, maintaining its cultural, historic, archaeological values, historic architecture and all its other unique values, as provided for in the legislation in force.</p>	<p>1.5 Princip oçuvanja i povećanja vrednosti opštinske javne imovine - podrazumeva da je korisnik opštinske imovine obavezan da koristi imovinu na takav naçin da oçuva njenu vrednost i koristi sve odgovarajuće mere za povećanje te vrednosti;</p> <p>1.6 Princip oçuvanja jedinstvenih karakteristika i vrednosti imovine - podrazumeva da korisnik opštinske imovine mora koristiti imovinu isključivo prema nameni imovine oçuvajući njene kulturne, istorijske, istorijsku arhitekturu i bilo koju drugu jedinstvenu vrednost, kako je definisano važećim zakonodavstvom.</p>
<p>KAPITULLI II DHËNIA NË SHFRYTËZIM E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Kriteret për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës</p> <p>1.Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës bazohet në këto kritere:</p>	<p>CHAPTER II ALLOCATION FOR USE OF IMMOVABLE PROPERTY OF THE MUNICIPALITY</p> <p style="text-align: center;">Article 5 Criteria for allocation for use of immovable property of the municipality</p> <p>1. Allocation for use of immovable property of the municipality shall be based on the following criteria:</p>	<p>POGLAVLJE II DAVANJE NA KORIŠĆENJE OPŠTINSKE NEPOKRETNE IMOVINE</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Kriterijumi za davanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine</p> <p>1. Davanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine zasniva se na sledećim kriterijumima:</p>

<p>1.1. Prona e paluajtshme e komunës për dhënien në shfrytëzim të jetë e regjistruar në regjistrat kadastral të pronës;</p> <p>1.2. Qëllimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme e komunës të jetë e harmonizuar me dokumentet e planifikimit hapësinor;</p> <p>1.3. Të ketë arsyeshmëri të interesit publik apo përfitimit ekonomik të komunës;</p> <p>1.4. Të plotësojë kushtet dhe kriteret e përcaktuara mjedisore.</p>	<p>1.1. Immovable property of the municipality to be allocated for use shall be registered in cadastral registers of property;</p> <p>1.2. The purpose of use of immovable property of the municipality shall be aligned with the spatial planning documents;</p> <p>1.3. Shall have public interest justification or economic benefit for the Municipality;</p> <p>1.4. Shall meet the given environmental conditions and criteria.</p>	<p>1.1. Nepokretna opštinska imovina za davanje na korišćenje da bude registrovana u katastarskim imovinskim registrima;</p> <p>1.2. Svrha korišćenja opštinske nepokretnosti da bude usklađena sa dokumentima prostornog planiranja;</p> <p>1.3. Da ima opravdanost javnog interesa ili ekonomske koristi opštine;</p> <p>1.4. Da ispuni utvrđene uslove i kriterijume životne sredine.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 6</p> <p style="text-align: center;">Afati i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të komunës</p>	<p style="text-align: center;">Article 6</p> <p style="text-align: center;">Period of allocation for use of immovable property of the municipality</p>	<p style="text-align: center;">Član 6</p> <p style="text-align: center;">Rok davanja na korišćenje opštinske nepokretne imovine</p>
<p>1. Komunat mund të japin në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës, për këto afate:</p> <p>1.1 Dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme të komunës, që nënkupton periudhën nga një (1) vit e deri në pesëmbëdhjetë (15) vite;</p> <p>1.2 Dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronës së paluajtshme të komunës, që</p>	<p>1. The municipalities can allocate for use the immovable property of the municipality for the following period:</p> <p>1.1 Allocation for short-term use of immovable property of the municipality, meaning the period from one (1) year to fifteen (15) years;</p> <p>1.2 Allocation for long-term use of immovable property of the municipality,</p>	<p>1. Opštine mogu dati na korišćenje opštinsku nepokretnu imovinu za sledeće rokove:</p> <p>1.1 Davanje na kratkoročno korišćenje opštinske nepokretne imovine što podrazumeva period od jedne (1) godine do petnaest (15) godina;</p> <p>1.2 Davanje na dugoročno korišćenje opštinske nepokretne imovine, što podrazumeva</p>

<p>nënkupton periudhën më shumë se pesëmbëdhjetë (15) vite deri nëntëdhjetë e nëntë (99) vite;</p> <p>1.3 Komunat mund të japin në shfrytëzim pronën e paluajtshme për me pak se një (1) vit. Procedurat dhe format për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për periudhën deri në një (1) vit rregullohen dhe përcaktohen me akt nënligjor të cilin do e nxjerr ministria përgjegjëse për vetëqeverisje lokale brenda afatit ligjor.</p>	<p>meaning the period of more than fifteen (15) years to ninety nine (99) years;</p> <p>1.3 Municipalities may allocate the immovable property for use for less than one (1) year. Procedures and forms for allocation for use of immovable property of the municipality for the period up to one (1) year shall be governed and determined with a bylaw to be issued by the ministry responsible for local self-government within the legal time limit.</p>	<p>period duže od petnaest (15) godina do devedeset devet (99) godina;</p> <p>1.3 Opštine mogu dati na korišćenje opštinsku nepokretnu imovinu za manje od jedne (1) godine. Procedure i oblici za davanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine za period do jedne (1) godine uređuju se i utvrđuju podzakonskim aktom koji donosi ministarstvo odgovorno za lokalnu samoupravu u zakonskom roku.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 7 Subjektet përfituese</p>	<p style="text-align: center;">Article 7 Benefiting entities</p>	<p style="text-align: center;">Član 7 Subjektii korisnici</p>
<p>1. Prona e paluajtshme e komunës mund të jipet në shfrytëzim të gjithë personave fizik dhe juridik që janë të evidentuar dhe regjistruar në Republikën e Kosovës.</p> <p>2. Përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni bëjnë rastet e veçanta të përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji dhe rastet e trajtuara me procedura të negocimit nga kryetari i komunës.</p> <p>3. Komunat mund të japin në shfrytëzim pronat e paluajtshme të komunës në periudhën afatshkurtër organizatave të shoqërisë civile me qëllim të përmbushjes së</p>	<p>1. Immovable property of the municipality may be allocated for use to all natural and legal persons recorded and registered in the Republic of Kosovo.</p> <p>2. Special cases as established in Article 20 of this Law and cases handled with negotiation procedures by the Mayor shall be exempted from paragraph 1 of this Article.</p> <p>3. Municipalities may allocate for use immovable properties of the municipalities for a short-term period to civil society organizations, in view of fulfilling the general</p>	<p>1. Nepokretna imovina opštine može se dati na korišćenje svim fizičkim i pranim licima koja su evidentirana i registrovana u Republici Kosovo.</p> <p>2. Izuzeci iz stava 1. ovog člana su posebni slučajevi iz člana 20. ovog zakona i slučajevi tretirani pregovaračkom procedurom od strane gradonačelnika.</p> <p>3. Opštine mogu kratkoročno dati na korišćenje opštinsku nepokretnu imovinu organizacijama civilnog društva kako bi se ispunio opšti interes.</p>

<p>interesit të përgjithshëm.</p> <p>4. Me akt nënligjor të propozuar nga ministria rregullohen dhe përcaktohen procedurat dhe format për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për subjektet përfituese, i cili miratohet në Qeveri.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës</p> <p>1. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës bëhet përmes procedurave të:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Ankandit publik 1.2. Shprehjes së interesit; dhe 1.3. Negociatave të Kryetarit të Komunës.</p> <p>2. Nuk mund të zhvillohet asnjë procedurë e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme pa u plotësuar kriteret e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji.</p> <p>3. Prona e cila do të jepet në shfrytëzim duhet të jetë pjesë e listës së publikuar për pronat e paluajtshme, ashtu siç është përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji.</p>	<p>interest.</p> <p>4. The bylaw proposed by the ministry shall govern and determine the procedures and forms for allocation for use of immovable property of the municipality for benefiting entities, which will be approved by the Government.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Procedures for allocation for use of immovable property of the municipality</p> <p>1. Allocation for use of immovable property of the municipality shall take place under the following procedures of:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Public Auction; 1.2. Expression of interest; and 1.3. Negotiations of the Mayor.</p> <p>2. No procedure for allocation for use of the immovable property can be carried out without the fulfilment of the criteria established in Article 5 of this Law.</p> <p>3. The property to be allocated for use shall be included in the published list of immovable properties, as determined in Article 12 of this Law.</p>	<p>4. Podzakonskim aktom predloženim od strane ministarstva, uređuju se i definišu procedure i oblici davanja na korišćenje opštinske nepokretne imovine korisničkim subjektima, koji se usvaja u Vladi.</p> <p style="text-align: center;">Član 8 Procedure za davanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine</p> <p>1. Davanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine vrši se putem sledećih procedura::</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Javna aukcija 1.2. Izražavanje interesa; i 1.3. Pregovori gradonačelnika.</p> <p>2. Ne može se obaviti nijedna procedura davanja na korišćenje nepokretne imovine bez ispunjenja kriterijuma iz člana 5. ovog zakona.</p> <p>3. Imovina koja se dati na korišćenje treba da bude deo objavljene liste nepokretne imovine kao što je definisano u članu 12 ovog zakona.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 9 Rregullimi i pronës nga komuna</p> <p>1. Me propozim të Kryetarit të Komunës, pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji, Kuvendi i Komunës merr vendim për ndërrimin e qëllimit të përdorimit të pronës së paluajtshme të komunës ku gjendet objekti i komunës duke rrënuar, bashkuar, ndarë pronën e paluajtshme të komunës, konform kushteve të pronës me qëllim të dhënies në shfrytëzim.</p> <p>2. Vendimi i Kuvendit të Komunës merret me shumicën e anëtarëve të përgjithshëm të Kuvendit të Komunës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 Regulation of property by the municipality</p> <p>1. Upon the proposal of the Mayor, following the fulfilment of the criteria set forth in Article 5 of this Law, the Municipal Assembly shall render a decision to change the purpose of use for the immovable property of the municipality where the municipal building is located by demolishing, merging, dividing the immovable property of the municipality, in compliance with the conditions of the property for the purpose of allocating for use.</p> <p>2. The decision of the Municipal Assembly shall be rendered by the majority of general members of the Municipal Assembly.</p>	<p style="text-align: center;">Član 9 Uredba imovine od strane opštine</p> <p>1. Na predlog gradonačelnika, nakon ispunjenja uslova iz člana 5. ovog zakona, Skupština opštine donosi odluku da promeni svrhu korišćenja opštinske nepokretne imovine u kojoj se nalazi objekt opštine rušeći, pripajajući, deleći opštinsku nepokretnu imovinu, u skladu sa uslovima imovine radi davanja na korišćenje.</p> <p>2. Odluka Skupštine opštine donosi se većinom članova Skupštine opštine.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 10 Kufizimet e komunës</p> <p>Kuvendi i Komunës dhe ekzekutivi i komunës nuk mund të merr asnjë vendim lidhur me dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nga dita kur Presidenti shpall zgjedhjet lokale.</p>	<p style="text-align: center;">Article 10 Restrictions for the municipality</p> <p>The Municipal Assembly and municipal executive cannot render any decision with regards to the allocation for use and exchange of immovable property of the municipality from the day when the president announces local elections.</p>	<p style="text-align: center;">Član 10 Ograničenja opštine</p> <p>Skupština opštine i opštinska izvršna vlast ne mogu doneti nikakve odluke u vezi sa korišćenjem i razmenom opštinske nepokretne imovine od dana kada Predsednik proglašava lokalne izbore.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 11 Të hyrat financiare</p> <p>Të hyrat financiare të komunës që realizohen nga dhënia në shfrytëzim e pronës,</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Financial revenues</p> <p>Municipal financial revenues generated from the allocation for use of the property shall be</p>	<p style="text-align: center;">Član 11 Finansijski prihodi</p> <p>Opštinski finansijski prihodi koji se ostvaruju davanjem na korišćenje imovine, smatraju se</p>

<p>konsiderohen para publike dhe i nënshtrohen legjislacionit për menaxhimin e financave publike dhe financat e pushtetit lokal.</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Publikimi i listës së pronave të paluajtshme të komunës</p> <p>1. Komuna duhet të publikon listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës, si dhe listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues deri me 31 dhjetor, duke arsyetuar interesin publik dhe zhvillimin ekonomik të komunës.</p> <p>2. Lista e pronave të paluajtshme për dhënien në shfrytëzim duhet të përmbaj këto të dhëna: të dhënat kadastrale të pronës, qëllimin, destinimin, datën e publikimit të njoftimit dhe periudhën kohore për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.</p>	<p>considered public funds and shall be subject to the legislation on public finance management and local government finance.</p> <p style="text-align: center;">Article 12 Publication of the list of immovable properties of the municipality</p> <p>1. The municipality shall publish the general list of immovable properties of the municipality, as well as special list of properties planned to be allocated for use for the coming year up to 31 December, justifying the public interest and economic development of the municipality.</p> <p>2. List of immovable properties for allocation for use shall contain the following data: cadastral data of the property, purpose, and destination, date of publication of the announcement and period for allocation for use of immovable property of the municipality.</p>	<p>javnim novcem i podležu zakonima o upravljanju javnim finansijama i finansijama lokalne samouprave.</p> <p style="text-align: center;">Član 12 Objavlјivanje spiska opštinskih nepokretnih imovina</p> <p>1. Opština treba da objavi opšti spisak opštinskih nepokretnih imovina kao i posebni spisak imovina koje se planiraju za davanje na korišćenje tekuće godine do 31. decembra, opravdavajući javni interes i ekonomski razvoj opštine.</p> <p>2. Spisak nepokretnih imovina za davanje na korišćenje treba da sadrži sledeće podatke: katastarske podatke imovine, svrhu, namenu, datum objavljivanja obaveštenja i vremenski period za davanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 13 Propozimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës</p> <p>1. Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës për miratim paraprak pronën e paluajtshme të komunës për dhënien në shfrytëzim, duke paraqitur arsyet dhe</p>	<p style="text-align: center;">Article 13 Proposal for allocation for use of immovable property of the municipality</p> <p>1. Mayor shall propose to the Municipal Assembly for preliminary approval the immovable property of the municipality allocated for use, by presenting the reasons and public interest.</p>	<p style="text-align: center;">Član 13 Predlog o davanju na korišćenje opštinske nepokretne imovine</p> <p>1. Gradonačelnik predlaže Skupštini opštine da prethodno odobri opštinsku nepokretnu imovinu za davanje na korišćenje, navodeći razloge i javni interes.</p>

<p>interesin publik.</p> <p>2. Propozimi për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës duhet të identifikojë të dhënat kadastrale të pronës, madhësinë e saj, të specifikojë arsyet, qëllimin, kohëzgjatjen si dhe formën në të cilën rekomandohet procesi për dhënie e pronës në shfrytëzim.</p> <p>3. Kuvendi i Komunës merr vendim paraprak për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës me shumicën e votave të përgjithshme të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.</p> <p>4. Vendimi paraprak për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.</p> <p>5. Pas marrjes së vendimit paraprak për dhënie në shfrytëzim të pronës përkatëse të komunës, komuna bën publikimin e njoftimit në faqen zyrtare të komunës për pronën e cila është në dispozicion për dhënie në shfrytëzim afatgjatë apo afatshkurtër.</p>	<p>2. The proposal to allocate for use the immovable property of the municipality shall identify cadastral data of the property, size, specific reasons, purpose and duration and recommended form for allocation of property for use.</p> <p>3. The Municipal Assembly shall render preliminary decision to allocate for use the immovable property of the municipality by the majority of votes of the Municipal Assembly's members.</p> <p>4. Preliminary decision for allocation for use of immovable property of the municipality shall be subject to mandatory review of legality, as established in the Law on Local Self-Government.</p> <p>5. After the preliminary decision on allocation for use of immovable property of the municipality is taken, the Municipality shall publish the announcement on the property available to be allocated for short-term use or long-term use in the Municipality's official website.</p>	<p>2. Predlog o davanju na korišćenje opštinske nepokretne imovine treba da identifikuje katastarske podatke o imovini, njenu veličinu, da navede razloge, svrhu, trajanje kao i oblik u kojem se preporučuje proces za davanje imovine na korišćenje.</p> <p>3. Skupština opštine donosi preliminarnu odluku o davanju na korišćenje opštinske nepokretne imovine većinom glasova od ukupnog broja glasova članova Skupštine opštine.</p> <p>4. Preliminarna odluka o davanju na korišćenje opštinske nepokretne imovine podleže obaveznom razmatranju zakonitosti, kao što je utvrđeno Zakonom o lokalnoj samoupravi.</p> <p>5. Nakon donošenja preliminarne odluke o davanju na korišćenje dotične opštinske imovine, opština objavljuje obaveštenje na zvaničnoj veb stranici opštine za imovinu koja je dostupna za dugoročno ili kratkoročno davanje na korišćenje.</p>
--	---	---

<p align="center">Neni 14 Njoftimi publik</p>	<p align="center">Article 14 Public announcement</p>	<p align="center">Član 14 Javno obaveštenje</p>
<p>1. Pas marrjes se vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, komuna bën njoftimin publik për pronën e cila jepet në shfrytëzim, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh kalendarike nga dita e publikimit.</p> <p>2. Njoftimi publik duhet të publikohet në faqen zyrtare të komunës, në tabelën e shpalljeve të komunës, në vendin ku gjendet prona e komunës e cila jepet në shfrytëzim dhe së paku në njërën nga mediat lokale të shkruara dhe elektronike.</p> <p>3. Njoftimi duhet të përmbajë të dhënat kadastrale të pronës, lokacionin, përshkrimin, kohëzgjatjen e shfrytëzimit, çfarëdo kushti apo kufizimi mbi dhënien e të drejtave për shfrytëzim, shfrytëzimin e lejuar të tokës, formën e konkurrencës, arsyeshmërinë për interesin publik apo zhvillimit ekonomik, çmimin fillestar, kërkesat për pjesëmarrje në konkurrim, përfshirë procedurat e regjistrimit të ofertuesve, kohën dhe vendin ku mbahet ankandi dhe hapja e ofertave.</p>	<p>1. After the preliminary decision on allocating the immovable property of the municipality for use is taken, the Municipality shall, within the time limit of fifteen (15) calendar days, publish the announcement on the property allocated for use.</p> <p>2. The public announcement shall be published on the municipal official website, in the municipality's announcements table, at the location of the municipal property subject to allocation and at least in one of the local press and electronic media.</p> <p>3. The announcement shall comprise cadastral data of the property, location, description, duration of use, any condition or restriction on the right of use, permitted use of land, competition form, justification for public interest or economic development, starting price, requirements for participating in the competition, including procedures for registering bidders, auction time and venue and opening of bids.</p>	<p>1. Nakon donošenja preliminarne odluke o davanju na korišćenje opštinske nepokretne imovine, opština objavljuje javno obaveštenje o imovini koja se daje na korišćenje, u roku od petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja..</p> <p>2. Javno obaveštenje se objavljuje na zvaničnoj veb stranici opštine, na oglasnoj tabli opštine, na mestu gde se nalazi opštinska imovina koja se daje na korišćenje i najmanje u jednom od lokalnih pisanih i elektronskih medija.</p> <p>3. Obaveštenje mora sadržati katastarske podatke o imovini, lokaciju, opis, trajanje korišćenja, bilo kakav uslov ili ograničenje o davanju prava na korišćenje, dozvoljeno korišćenje zemljišta, oblik konkurisanja, opravdanost javnog interesa ili ekonomskog razvoja, početnu cenu, zahteve za učešće na konkurisanju, uključujući procedure registracije ponuđača, vreme i mesto na kome se održava aukcija i otvaranje ponuda.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 15 Paraqitja e ofertave</p> <p>1. Personat fizik dhe juridik mund të paraqesin ofertat e tyre për marrjen në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës, për periudhën afatshkurtër apo afatgjatë, bazuar në njoftimin publik të komunës.</p> <p>2. Ofertat duhet të jenë të mbyllura dhe të protokollohen në Njësinë për Administrimin e Dokumenteve të Komunës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 15 Submission of bids</p> <p>1. Natural and legal persons may submit their bids for obtaining for use the immovable properties of the municipality for the short-term or long-term period, according to the public announcement of the Municipality.</p> <p>2. Bids shall be closed and protocolled in the Municipal Document Administration Unit.</p>	<p style="text-align: center;">Član 15 Podnošenje ponuda</p> <p>1. Fizička i pravna lica mogu da podnesu svoje ponude za korišćenje opštinske nepokretne imovine na kratkoročni ili dugoročni period, na osnovu opštinskog javnog obaveštenja.</p> <p>2. Ponude moraju biti zatvorene i protokolisane u Jedinici za upravljanje opštinskim dokumentima.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 16 Komisioni vlerësues</p> <p>1. Për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, formohet Komisioni Vlerësues në përbërje prej pesë (5) anëtarëve.</p> <p>2. Kryetari i Komunës i propozon dy (2) anëtar nga ekzekutivi i komunës, Kuvendi i Komunës propozon dy (2) anëtar nga Kuvendi i Komunës nga radhët e subjekteve të ndryshme politike dhe një (1) anëtar nga sektori jo qeveritar, i cili propozohet nga sektori jo qeveritar lokal.</p>	<p style="text-align: center;">Article 16 Evaluation Commission</p> <p>1. The Evaluation Commission shall be established to carry out procedures for allocating for use the immovable property of the municipality and shall be composed of five (5) members.</p> <p>2. Mayor shall nominate two (2) members from the municipal executive, the Municipal Assembly shall nominate two (2) members from the Municipal Assembly among different political entities and one (1) member among the non-governmental sector, who is proposed by the local non-governmental sector.</p>	<p style="text-align: center;">Član 16 Komisija za procenu</p> <p>1. U cilju sprovođenja procedura za davanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine, formira se Komisija za procenu sastavljena od pet (5) članova.</p> <p>2. Gradonačelnik predlaže dva (2) člana stručnjaka iz izvršne vlasti opštine, Skupština opštine predlaže dva (2) člana iz Skupštine opštine i jedan (1) član iz nevladinog sektora, kojeg predlaže lokalni nevladini sektor.</p>

<p>3. Vendimi për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të komisionit aprovet në Kuvendin e Komunës me shumicën e votave të përgjithshme të anëtarëve të kuvendit.</p> <p>4. Vendimi i Kuvendit të Komunës për themelimin e komisionit vlerësues duhet të përmbajë detyrat, përgjegjësitë dhe çështjet tjera të cilat konsiderohen të rëndësishme për punën e komisionit vlerësues.</p> <p>5. Administrata e komunës ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.</p> <p>6. Për secilin vendim paraprak të Kuvendit të Komunës formohet komisioni vlerësues.</p>	<p>3. The decision for nomination and dismissal of the Commission's members shall be approved by the Municipal Assembly with the majority of general votes of the assembly members.</p> <p>4. The decision of the Municipal Assembly for establishing the Evaluation Commission shall contain duties, responsibilities and other issues considered as important for the work of the Evaluation Commission.</p> <p>5. The Municipal Administration shall provide support to the Evaluation Commission for allocation for use of immovable property of the Municipality.</p> <p>6. An Evaluation Commission shall be established for each preliminary decision of the Municipal Assembly.</p>	<p>3. Odluka o imenovanju i razrešenju članova Komisije usvaja se u Skupštini opštine većinom ukupnih glasova članova Skupštine.</p> <p>4. Odluka skupštine opštine o osnivanju Komisije za procenu treba da sadrži zadatke, odgovornosti i druga pitanja koja se smatraju važnim za rad Komisije za procenu.</p> <p>5. Opštinska administracija pruža podršku Komisiji za procenu davanja na korišćenje opštinske nepokretne imovine.</p> <p>6. Za svaku preliminarnu odluku Skupštine opštine formira se Komisija za procenu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 17 Komisioni i ankesave</p>	<p style="text-align: center;">Article 17 Appeal Commission</p>	<p style="text-align: center;">Član 17 Komisija za žalbe</p>
<p>1. Kuvendi i Komunës formon Komisionin e Ankesave i cili do të shqyrtojë ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, në përbërje prej pesë (5) anëtarëve.</p> <p>2. Kryetari i Komunës i propozon dy (2) anëtarë nga ekzekutivi i komunës, Kuvendi i</p>	<p>1. Municipal Assembly shall establish the Appeal Commission, which shall review the appeals of parties in the procedure for allocation of short-term and long-term use of immovable property of the municipality, which shall be composed of five (5) members.</p> <p>2. The Mayor shall nominate two (2) members from the municipal executive, the Municipal</p>	<p>1. Skupština opštine formira Komisiju za žalbe koja će razmatrati žalbe strana u proceduri davanja na kratkoročno i dugoročno korišćenje opštinske nepokretne imovine, koja se sastoji od pet (5) članova.</p> <p>2. Gradonačelnik predlaže dva (2) člana i izvršne vlasti opštine, Skupština opštine predlaže dva (2)</p>

<p>Komunës propozon dy (2) anëtar nga Kuvendi i Komunës nga radhët e subjekteve të ndryshme politike dhe një (1) anëtar nga sektori jo qeveritar, i cili propozohet nga sektori jo qeveritar lokal.</p> <p>3. Vendimi për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të komisionit aprohet në Kuvendin e Komunës me shumicën e votave të përgjithshme të anëtarëve të kuvendit.</p> <p>4. Vendimi i Kuvendit të Komunës për themelimin e komisionit të ankesave duhet të përmbajë detyrat, përgjegjësitë dhe çështjet tjera të cilat konsiderohen të rëndësishme për punën e komisionit të ankesave.</p> <p>5. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit të ankesave sipas kërkesës së tyre.</p> <p>6. Mandati i komisionit të ankesave është dy (2) vjeçar brenda mandatit të Kuvendit të Komunës.</p>	<p>Assembly shall nominate two (2) members from the Municipal Assembly among the different political entities and one (1) members from the non-governmental sector, who shall be proposed by the local non-governmental sector.</p> <p>3. The decision for nomination and dismissal of Commission's members shall be approved in the Municipal Assembly by a majority of total votes of Assembly members.</p> <p>4. The Decision of the Municipal Assembly to establish the Appeal Commission shall contain duties and responsibilities and other issues deemed significant for the work of the Appeal Commission.</p> <p>5. Municipal Administration shall provide support to the Appeal Commission, upon their request.</p> <p>6. The mandate of the Appeal Commission shall be two (2) years within the mandate of the Municipal Assembly.</p>	<p>člana iz Skupštine opštine iz redova različitih političkih subjekata i jednog (1) člana iz nevladinog sektora, kojeg predlaže lokalni nevladini sektor.</p> <p>3. Odluka o imenovanju i razrešenju članova Komisije usvaja se u Skupštini opštine većinom ukupnih glasova članova Skupštine.</p> <p>4. Odluka skupštine opštine o osnivanju Komisije za žalbe treba da sadrži zadatke, odgovornosti i druga pitanja koja se smatraju važnim za rad Komisije za žalbe.</p> <p>5. Opštinska administracija pruža podršku Komisiji za žalbe na njen zahtev.</p> <p>6. Mandat Komisije za žalbe je dve (2) godine u okviru mandata Skupštine opštine.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 18 Vlerësimi i ofertave</p>	<p style="text-align: center;">Article 18 Bids Evaluation</p>	<p style="text-align: center;">Član 18 Procena ponuda</p>
<p>1. Komisioni vlerësues, pas pranimit të ofertave e bën vlerësimin e tyre në përputhje me kushtet e përcaktuara në njoftimin publik.</p>	<p>1. The Evaluation Commission, following the receipt of bids, shall perform their evaluation in compliance with the conditions set forth in</p>	<p>1. Komisija za procenu, po prijemu ponuda, vrši njihovu procenu u skladu sa uslovima navedenim u javnom obaveštenju. Obaveštenje o</p>

